



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**  
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E THESARIT**  
**Drejtoria e Kontabilitetit**

Nr. 9791 Prot.

Tirane me 27/12/ 2007

**U D H E Z I M**

**Nr. 26 date 27 / 12 / 2007**

**PER DISA SHTESA E NDRYSHIME NE UDHEZIMIN E MINISTRIT TE  
FINANCAVE NR.14 DATE 28/12/2006 “ PER PERGATITJEN DHE  
RAPORTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE VJETORE PER INSTITUCIONET  
QENDRORE, ORGANET E PUSHTETIT VENDOR DHE NJESIVE QE VAREN  
PREJ TYRE SI DHE TE NJESIVE TE MENAXHIMIT / ZBATIMIT TE  
PROJEKTEVE E MARRVESHJEVE ME DONATORE TE HUAJ**

Ne zbatim te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 248 date 10.04.1998, te ndryshuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr.25 date 20.01.2001, "Per Miratimin e Planit Kontabel Publik te Organeve te Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetore Qendrore e Lokale si dhe njesive qe varen prej Tyre", me propozim te Drejtorise se Kontabilitetit ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit, per pergatitjen dhe Raportimin e Pasqyrave Financiare te vitit 2007 ;

**U D H E Z O J :**

Disa shtesa e ndryshime ne Udhezimin e Ministrit te Financave nr. 14 date 28/12/2006 “ Per pergatitjen dhe raportimin e pasqyrave Financiare te vitit 2006 per Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njesive qe varen prej tyre si dhe te njesive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marreveshjeve me donatore te huaj”, si me poshte :

1. Pergatitja dhe raportimi i Pasqyrave Financiare te vitit 2007 nga te gjitha institucionet buxhetore dhe njesite e menaxhimit / zbatimit te projekteve te behet mbi bazen e Udhezimit nr. 14 date 28/12/2006 si dhe te shtesave e ndryshimeve te tij qe behen me kete udhezim.
2. **Ne Rubriken (I) te Udhezimit nr. 14 date 28/12/2006** behen keto shtesa e ndryshime:

**Pika (1)ne rubriken (I) ndryshohet, zevendesohet si vijon;**

**Pasqyrat Financiare Vjetore individuale te vitit 2007** per te gjitha Institucionet Qendrore, Vendore dhe njesive qe varen prej tyre si dhe te njesive te menaxhimit / zbatimit te projekteve me donatore te huaj te pergatiten dhe raportohen sipas formatit te miratuar qe gjendet ngjitur ketij udhezimi. Perberesit dhe formatet e Pasqyrave Financiare jane ;

- Bilanci kontabel (aktivi dhe pasivi sipas formateve nr. 1 e nr.2).
- Pasqyrat e shpenzimeve dhe te ardhurave te ushtrimit (Formatet nr. 3/1 e nr.3/2).
- Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (Formati nr. 4).
- Pasqyra mbi levizjen "CASH" (Formati nr. 5).
- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet ne Aktivet e Qendrushme si dhe amortizimin e tyre (Formatet nr. 6 e nr. 7).
- Pasqyra e levizjes se fondeve (Formati nr. 8).
- Pasqyre mbi numrin e punonjesve dhe fondin e pagave (Formati nr. 9).
- Pytesor me te dhena e shenime shpjeguese per hartimin e Pasqyrave Financiare (Formati nr.10).

**Ministrite dhe Institucionet e tjera Qendrore**, fillimisht hartojne Permbledhesen e thjeshte te Pasqyrave Financiare Vjetore te vitit 2007 me perberjen si me siper per te gjitha institucionet e vartese. Pavec sa me siper ato(tw cilat kane njesi vartese) hartojne edhe Permbledhesen e Konsoliduar per dy Pasqyra Financiare si ;

- Pasqyre Permbledhese e Konsoliduar e Gjendjes Financiare (Formati nr. 10)
- Pasqyre Permbledhese e Konsoliduar e te ardhurave dhe shpenzimeve te funksionimit (Formati nr.11)

**Ne piken (3) te rubrikes (I) shtohet paragrafi me kete permbajtje;**

"Institucionet e Qeverisjes Vendore qe kane njesi vartese pavec Permbledheses se thjeshte hartojne dhe depozitojne ne afatet perkatese edhe dy Pasqyrat Financiare te Konsoliduara te permendura me siper per vitin 2007".(formatet nr. 10 dhe nr. 11).

**Ne piken (5) te rubrikes (I) shtohet paragrafi me kete permbajtje;**

"Ministrite dhe Institucionet e tjera Qendrore pavec Permbledheses se Thjeshte te Pasqyrave Financiare depozitojne ne Ministrine e Financave (ne afatet e percaktuara) edhe dy Pasqyrat Financiare te Konsoliduara te vitit 2007" (formatet nr. 10 dhe nr. 11).

**Ne piken (6) te rubrikes (I) shtohet paragrafi me kete permbajtje**

"Deget e Thesarit ne rrethe, pavec Permbledheses se Thjeshte te Pasqyrave Financiare te Institucioneve te Qeverisjes Vendore te juridiksionit te tyre, depozitojne edhe informacion tjeter te kerkuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit.

3. **Datat e depozitimit te Pasqyrave Financiare** jane ato te percaktuara ne Udhezimin e Ministrit te Financave nr. 14 date 28/12/2006 por per llogari te depozitimit te Pasqyrave Financiare te vitit 2007.

4. **Ne rubriken (III)** te Udhezimit te Ministrit te Financave nr.14 date 28/12/2006, lidhur me permbajtjen dhe rregullat e plotesimit te Pasqyrave Financiare te vitit 2007, behen keto shtesa e ndryshime;

**Pikat (3) dhe (4) te rubrikes (III)** nuk ndryshojne nga pikpamja e permbajtjes dhe rregullave te plotesimit, vecse formatet 1/1 dhe 1/2 emertohen respektivisht “**Formati 3/1**” dhe “**Formati 3/2**”.

**Pikat (5) dhe (6) te rubrikes (III) ndryshohen**, zevendesohen me kete permbajtje;

Formati 4 emertohet “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet”. Kjo pasqyre paraqet levizjet dhe tepricat e analizuara te llogarive te burimeve te lidhura me investimet (Grante te brendshme e te huaja kapitale ,mjete te veta kapitale, huamarrje te brendshme e te huaja) dhe shpenzimet per investime, transfertat kapitale, huadhenie e nenhuadhenie, pjesmarrjet ne kapitalin e vet).

Kjo pasqyre ndahet ne dy grupe te medha ;

- o Grupi – I – Burimet e Investimeve(rrjeshti 1)
- o Grupi – II – Shpenzimet per investime(rrjeshti 33)

Ne te dy grupet jepen analizat e llogarive dy, tre dhe kater shifrore sipas ertimeve per burimet dhe shpenzimet per investime.

**Per grupin (I)**, per cdo rrjesht analitik, kolona (f) perbehet nga kolonat (c+e-d). Ne kete rubrike tepricat ne celje e ne mbyllje jane ne sensin kreditor (llogarite 105,106,14,11,12,16,17). Qelizat me – x – nuk plotesohen.

**Per grupin (II)**, per cdo rrjesht analitik, kolona (f) perbehet nga kolonat (c+d-e). Ne kete rubrike tepricat ne celje e ne mbyllje jane ne sensin debitor (llogarite 230,231,232,25,26). Qelizat me – x – nuk plotesohen.

**Sipas kolonave;** Grupi I (rrjeshti 1) eshte e barabarte me shumen algjebrike te rrjeshtave (2+7+11+14+18+19+26), rrjeshta te cilet perbejne shumen respektive te nenzerave perkates. Grupi II (rrjeshti 33) eshte e barabarte me shumen algjebrike te rrjeshtave (34+35+45+46+51), rrjeshta te cilet perbejne shumen respektive te nenzerave perkates. Totali i kesaj pasqyre (rrjeshti 56), per cdo kolone, perben shumen e dy grupeve ne rrjeshtat (1+33).

**Tepricat ne celje e ne mbyllje te ushtrimit** te kesaj pasqyre duhet te jene detyrimisht te barabarta me tepricat respektive ne pasiv e aktiv te bilancit kontabel.

**Pikat (7) e rubrikes (III) ndryshohet, zevendesohet me kete permbajtje:**

**Formati nr. 5 emertohet** – Pasqyre e levizjeve ne “Cash”-. Ne kete pasqyre jepet nje tablo e gjendjeve dhe levizjeve te mjeteve monetare te institucionit gjate vitit ushtrimor ne **Thesar** dhe ne **Banke**.

Shifrat e paraqitura ne rubrikat e Disponibiliteteve ne Thesar duhet te kontrollohen vecanerisht nga inspektorët e kontabilitetit per realizimin e perputhjes se tyre me shifrat e deges se Thesarit.

**Rrjeshti 1** pasqyron ne kolonen “Debi” tepricen ne celje te vitit ushtrimor te mjeteve monetare disponibel ne thesar dhe ne Banke e cila duhet te

jete e barabarte me llogarite perkatese (520 e 512) tek postet ne celje te llogarive financiare ne aktiv te bilancit kontabel.

**Arketimet ne Cash** (rrjeshti 2, kolona “c” dhe “e”) jane shume e rrjeshtave 3 deri ne 6 sipas pershkrimeve. Rrjeshti 3 = 4+5 dhe rrjeshti 6 = shumet e rrjeshtave 7 deri 13. Ne kete rubrike qelizat me shenjen “x” nuk plotesohen.

**Pagesat e vitit ne Cash** (rrjeshti 14, kolonat « d » dhe « f ») jane shume e rrjeshtave 15 deri 20 sipas pershkrimeve. Ne kete rubrike qelizat me shenjen “x” nuk plotesohen.

**Transferta** (rrjeshti 21) perfaqeson shumen sipas kolonave te rrjeshtave 22 deri 24 sipas pershkrimeve. Ne kete rubrike, qelizat me “x” nuk plotesohen.

**Shuma e levizjeve**” (rrjeshti 25) pasyron sipas kolonave totalin e levizjeve debitore dhe kreditore te mjeteve monetare te pasqyruara ne rrjeshtat (1+2+14+21).

**Teprica ne mbyllje**” (rrjeshti 26, kolonat “c” dhe “e” ) pasqyrojne respektivisht tepricen e llogarise se disponibiliteteve ne Thesar e ne Banke ne fund te vitit ushtrimor. Ne kete pasqyre keto jane te barabarte perkatesisht me diferencen pozitive midis levizjeve debitore dhe kreditore te rrjeshtit 25. Keto teprica duhet te jene detyrimisht te barabarta me tepricat e pasqyruara ne aktiv te bilancit kontabel, per postet e ushtrimit te mbyllur.

**Pikat (8) dhe (9) te rubrikes (III)** nuk ndryshojne nga pikpamja e permbajtjes dhe rregullave te plotesimit, vecse formatet 4 dhe 5 emertohen respektivisht “**Formati 6**” dhe “**Formati 7**”.

**Pika (10) e rubrikes (III) ndryshohet, zevendesohet me kete permbajtje:**

**Formati 10 emertohet** “Pasqyre e levizjes se fondeve”. Ne kete pasqyre evidentohen sipas emertimeve ne rrjeshta, kollonat qe perfaqesojne gjendjet ne fillim, levizjet e periudhes (shtesa apo paksim) dhe gjendjet ne fund te periudhes ushtrimore lidhur me fondet e veta te institucioneve (Grupi A i pasivit te bilancit kontabel).

**Sipas Kolonave;** Fondet baze (rrjeshti 1, llogaria 101) perfaqeson shumen e rrjeshtave 2 deri 8, Fondi i brendshem (rrjeshti 10) perfaqeson shumen e rrjeshtave 11 deri 18, Fondi i jashtem (rrjeshti 19) eshte shuma e rrjeshtave 20 e 21. Totali i Fondit te Konsoliduar (rrjeshti 22) eshte shuma e rrjeshtave (1+9+10+19).

**Sipas rrjeshtave;** Teprica ne mbyllje (kolona 4) = (kolona 1, teprice celje) + (kolona 3, kreditimet) – (kolona 2, debitimet). Qelizat e shenuara ne kete pasqyre me shenjen “X” nuk plotesohen.

**Tepricat ne celje dhe ne mbyllje** te llogarive respektive te fondeve duhet detyrimisht te jene te rakorduara me te dhenat e ketyre llogarive te pasqyruara ne grupin A te pasivit te bilancit kontabel.

**Pika (11) e rubrikes (III)** nuk ndryshon nga pikpamja e permbajtjes dhe rregullave te plotesimit, vecse formati 7 emertohet “**Formati 9**” .

5. **Per Konsolidimin e Pasqyrave Financiare**, Pasqyra e Konsoliduar e Gjendjes Financiare (Formati 10) dhe Pasqyra e Konsoliduar e te Ardhurave e Shpenzimeve te Funkcionimit (Formati 11) te vitit 2007, jepen me hapa procedurat si me poshte;
- Ministrite dhe Institucionet e Tjera Qendrore si dhe Organet e Qeverisjes Vendore, mbi bazen e Pasqyrave Financiare Individuale te paraqitura nga njesite buxhetore te vartesis ( me kontabilitet me vehte), fillimisht hartojne permbledhesen ne rang sistemi per Pasqyra Financiare (Formatet nr. 1 deri nr.9).
  - Permbledhja e thjeshte behet duke renditur e mbledhur ze per ze rubrikat, postet e analizat e cdo Pasqyre Financiare individuale te vitit 2007. Per nje informacion te sakte e te besushem teknikisht, Pasqyrat Financiare Individuale duhet te jene te pergatitura e te rakorduara nga njesite shpenzuse, ne perputhje me Udhezimin e Ministrit te Financave nr. 14 date 28/12/2006 dhe shtesave e ndryshimeve te tij qe behen me kete udhezim.
  - Mbas kesaj procedure del e hartuar Permbledhja e thjeshte e gjithe pasqyrave financiare individuale (Formatet nr.1 deri nr.9) e cila raportohet si e tille.
  - Mbi bazen e Pasqyrave Financiare te hartuar si permbledhje e thjeshte, vecohen e analizohen per cdo njesi shpenzuse, per efekte konsolidimi (eliminimi e mosdublimi);
    - Permbledhja e thjeshte e Pasqyrave Financiare sipas formateve nr.1 e nr.2 (per aktivin e pasivin e bilancit kontabel) - per te finalizuar formatin nr.10 "Pasqyre e konsoliduar e Gjendjes Financiare".
    - Permbledhja e thjeshte e Pasqyrave Financiare sipas formatit nr. 3/1 e 3/2 (shpenzimet dhe te ardhurat e ushtrimit) – per te finalizuar formatin nr. 11 "Pasqyre e konsoliduar e te ardhurave e shpenzimeve te funksionimit".
  - **Per Formatin 10** "Pasqyre e konsoliduar e gjendjes financiare"
    - Per rrjeshtat 4 deri 12 te formatit 10 (arka, banka dhe disponibilitete), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshtat 55 deri 63 te permbledhjes nga formati nr. 1 (aktivi i bilancit kontabel).
    - Per rrjeshtat 14 deri 28 te formatit 10 (llogari te arketushme), merret fillimisht informacioni nga rrjeshtat 39 deri 53 te permbledhjes nga formatit nr. 1(aktivi i bilancit kontabel). Pastaj konsolidohen postet e llogarive 431,432,433,435,436,437 e 438,44,45 duke i krahasuar me te njejtat llogari ne postet respektive te detyrimeve ne permbledhjen e formatit nr. 2(pasivi i bilancit kontabel). Ne rast se diferencat midis tyre jane debitore, keto diferenca evidentohen ne postet perkatese te rubrikes se llogarive te arketushme te formatit nr. 10 "Pasqyre e konsoliduar e gjendjes financiare".
    - Per rrjeshtat 30 deri 38 te formatit 10 (llogarite e gjendjes se inventarit), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshtat 29 deri 37 te permbledhjes nga formati nr. 1 (aktivi i bilancit kontabel).

- Per rrjeshtat 41,42,43 te formatit 10 (investime), merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 8,20,21 te permbledhjes nga formati nr. 1 (aktivi i bilancit kontabel).
- Per rrjeshtat 45,46 te formatit 10 (aktive financiare), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshtat 25,26 te permbledhjes nga formati nr. 1 (aktivi i bilancit kontabel).
- Per rrjeshtat 48 deri 59 te formatit 10 (aktive te qendrushme te trupezuara), merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 10 deri 19 dhe 22 deri 23 te permbledhjes nga formati nr. 1 (aktivi i bilancit kontabel).
- Per rrjeshtat 61,62,63,64 te formatit 10 (aktive qendrushme te pa trupezuara), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshtat 4,5,6,7 te permbledhjes nga formati nr. 1 (aktivi i bilancit kontabel).
- Per rrjeshtat 66,67,68 formatit 10 (aktive te tjera), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshtat 65,66,67 te permbledhjes nga formati nr. 1 (aktivi i bilancit kontabel).
- Per rrjeshtat 72 deri 87 te formatit 10 (llogari te pagushme), merret fillimisht informacioni nga rrjeshtat 21 deri 36 te permbledhjes nga formatit nr. 2(pasivi i bilancit kontabel). Pastaj konsolidohen postet e llogarive 431,432,433,435,436,437 e 438,44,45 duke i krahasuar me te njejtat llogari ne postet respektive te te drejtave ne permbledhjen e formatit nr. 1(aktivi i bilancit kontabel). Ne rast se diferencat midis tyre jane kreditore, keto diferenca evidentohen ne postet perkatese te rubrikes se llogarive te pagushme te formatit nr. 10 "Pasqyre e konsoliduar e gjendjes financiare".
- Per rrjeshtat 88 dhe 90 te formatit 10 (huamarrje e brendshme dhe huamarrje e jashtme), merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 18 dhe 19 te permbledhjes nga formati nr. 2 (pasivi i bilancit kontabel).
- Per rrjeshtat 92 deri 95 te formatit 10 (pasive te tjera), merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 38 dhe 41 te permbledhjes nga formati nr. 2 (pasivi i bilancit kontabel).
- Mbas ketij evidentimi behen rakordimet e Pasyres se Konsoliduar te gjendjes financiare (formati nr.10) qe perfaqesohen nga; Grupi A – AKTIVE (rrjeshti 1) = shumen e rrjeshtave(2+39+65) dhe Grupi B – PASIVE(rrjeshti 69) = shumen e rrjeshtave(70+89+91). Ne vetevehte aktivet perbehen nga aktivet qarkulluse(rrjeshti 2 = rrjeshtat 3+13+29), aktivet jo qarkulluse(rrjeshti 39 = rrjeshtat 40+44+47+60) dhe aktive te tjera(rrjeshti 65 = rrjeshtat 66+67+68). Ne vetevehte pasivet perbehen nga detyrimet qarkulluse(rrjeshti 70 = rrjeshtat 71+88), detyrimet jo qarkulluse(rrjeshti 89 = rrjeshtin 90) dhe pasive te tjera(rrjeshti 91 = rrjeshtat 92+93+94+95).  
Ne nen rubrikat e tjera te kesaj pasyre jane shuma e analizave r espektive sipas posteve.
- **Aktivet neto (Klasa 1 ne pasiv te Bilancit)** perbejne diferencen midis AKTIVEVE(rrjeshti 1) dhe PASIVEVE(rrjeshti 69) qe perfaqesohet nga fondi i konsoliduar (rrjeshti nr. 97). Ne kete fond perfshihen edhe rezultatet e mbartura apo dhe rezultatet e

periudhes ushtrimore te cilat duhet te konsolidohen e raportohen ne rrjeshtin 98 te kesaj pasyre (shenja + - sipas rastit). Fondet e konsoliduar duhet te rakordohen me klasen 1(totalin e fondeve te veta) dhe llogarine 85 (Rezultatet e ushtrimit). Ne rrjeshtin 98 te kesaj pasqyre rezultatet e mbartura e te ushtrimit konsolidohen ne vleren neto te tyre.

▪ **Per Formatin 11** "Pasqyre e konsoliduar e te ardhurave dhe shpenzimeve te funksionimit."

- Per rrjeshtat 4 deri 10 te formatit 11 (te ardhura tatimore), merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 3,8,12,18,23,24,25 te permbledhjes nga formati nr. 3/2 (te ardhurat e ushtrimit). Kjo rubrike plotesohet nga DPT dhe nga Organet e Qeverisjes Vendore.
- Per rrjeshtat 12 deri 18 te formatit 11 (kontribute te sigurimeve shoqerore e shendetesore), merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 19 deri 33 te permbledhjes nga formati nr. 3/2 (te ardhurat e ushtrimit). Kjo rubrike plotesohet nga ISSH dhe ISKSH. Ne kete pasqyre te konsoliduar duhet te bere kujdes per rakordimet midis DPT, ISSH dhe ISKSH lidhur me evidentimin e te njetit informacion. Keto Institucione duhet te dergojne ngjitur me Pasqyrat Financiare edhe akt-rakordimet e bera midis tyre.
- Per rrjeshtat 20,21,22 te formatit 11 (te ardhura jo tatimore), merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 35,39,47 te permbledhjes nga formati nr. 3/2 (te ardhurat e ushtrimit).
- Per rrjeshtat 24,25 te formatit 11 (grante korente te pergjithshme), fillimisht merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 49,59 te permbledhjes nga formati nr. 3/2 (te ardhurat e ushtrimit). Me pas analizohen te gjitha llojet e granteve te marra te evidentuara ne analizat e llogarive 720 e 721, per cdo institucion te evidentuar ne permbledhjen e thjeshte. Ne llogarine 720 "Grante korente te brendshme " nuk duhet te perfshihen (te konsolidohen duke i eliminuar per efekte dublimi) grantet qe lidhen me transfertat si shpenzime nga institucionet Qendrore ne institucionet e vartesise (nqs eshte vepruar ne kontabilitet); nuk duhet te perfshihet(te eliminohen llogarite 7204"Pjesmarrje te institucioneve ne tatime nacionale" dhe 7205 "Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit".
- Per rrjeshtat 27 deri 30 te formatit 11 (te ardhura financiare), merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 71 deri 74 te permbledhjes nga formati nr. 3/2 (te ardhurat e ushtrimit).
- Per rrjeshtin 31 te formatit 11 (punime per investime e rimarrje), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshti 63 te permbledhjes nga formati nr. 3/2 (te ardhurat e ushtrimit).
- Per rrjeshtin 32 te formatit 11 (te ardhura te tjera), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshti 75 te permbledhjes nga formati nr. 3/2 (te ardhurat e ushtrimit).

- Per rrjeshtat 36,37 te formatit 11 (Paga dhe kontribute personeli), merret respektivisht informacioni i rakorduar nga rrjeshtat 3,8 te permbledhjes nga formati nr. 3/1 (shpenzime te ushtrimit).
- Per rrjeshtat 39 deri 48 te formatit 11 (mallra e sherbime), merret respektivisht informacioni i rakorduar nga rrjeshtat 12 deri 21 te permbledhjes nga formati nr. 3/1 (shpenzime te ushtrimit).
- Per rrjeshtin 49 te formatit 11 (Subvecone), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshti 22 te permbledhjes nga formati nr. 3/1 (shpenzime te ushtrimit).
- Per rrjeshtin 50 te formatit 11 (transferime korente te brendshme), fillimisht merret informacioni i rakorduar ne rrjeshtin 28 te permbledhjes nga formati nr. 3/1 (shpenzime te ushtrimit). Me pas analizohen te gjitha llojet e shpenzimeve te transferuara te evidentuara ne analizat e kesaj llogarie , per cdo institucion te evidentuar ne permbledhjen e thjeshte. Ne llogarine 604 "transferime korente te brendshme " nuk duhet te perfshihen (te konsolidohen duke i eleminuar per efekte dublimi) transfertat qe lidhen me grantet e marra nga institucionet e vartese e te dhena nga Institucionet Qendrore (nqs eshte vepruar ne kontabilitet). Eleminimet(ne se eshte e nevojshme behen midis llogarise 604 „Transferime te brendshme korente“ dhe llogarise 720“Grante te pergjithshme te brendshme korente“.
- Per rrjeshtin 51 te formatit 11 (transferime korente me jashte), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshti 33 te permbledhjes nga formati nr. 3/1 (shpenzime te ushtrimit).
- Per rrjeshtin 52 te formatit 11 (transferime per buxhete familjare e individe), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshti 38 te permbledhjes nga formati nr. 3/1 (shpenzime te ushtrimit). Ketu duhet te mbahet parasysh fakti ne rast se ka transfertat te tilla ne institucionet e vartese nga njesite qendrore, per te shmangur dublimet e informacionit te konsoliduar.
- Per rrjeshtin 53 te formatit 11 (kuota amortizimi e shuma te parashikuara), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshti 42 te permbledhjes nga formati nr. 3/1 (shpenzime te ushtrimit). Kjo vlen vetem per rastet kur institucionet kane aktivitet tregetar.
- Per rrjeshtat 55,56 te formatit 11 (shpenzime financiare), merret informacioni i rakorduar respektivisht nga rrjeshtat 48,53 te permbledhjes nga formati nr. 3/1 (shpenzime te ushtrimit).
- Per rrjeshtin 57 te formatit 11 (shpenzime te tjera), merret informacioni i rakorduar nga rrjeshti 57 te permbledhjes nga formati nr. 3/1 (shpenzime te ushtrimit).
- **Mbas ketij evidentimi** behen rakordimet e Pasyres se Konsoliduar te te te ardhurave dhe shpenzimeve te funksionimit (formati nr.11) qe perfaqesohen nga; Grupi A – TE ARDHURA GJITHSEJ (rrjeshti 1) = shumen e rrjeshtave(2+23+26+31+32) dhe Grupi B – SHPENZIME GJITHSEJ (rrjeshti 33) = shumen e rrjeshtave(34+53+54+57). Ne vetevete **te ardhurat** perfaqesohen nga te ardhura e kontribute (rrjeshti 2 = rrjeshtat 3+11+19) te analizuara, grantet korente (rrjeshti 23 = rrjeshtat



34+25), te ardhurat financiare(rrjeshti 26 = rrjeshtat 27+28+29+30), punime per investime e rimarrje(rrjeshti 31) dhe te ardhura te tjera(rrjeshti 32). Ne vetevete shpenzimet korente perbehen nga Paga e kontribute (rrjeshti 35 = rrjeshtat 36+37), mallra e sherbime(rrjeshti 38 = rrjeshtat 39 deri 48), subvecionet (rrjeshti 49), transfertat korente te brendshme(rrjeshti 50), transferta te jashtme (rrjeshti 51) dhe transferta per buxhete familjare e individet(rrjeshti 52. Nenrubrikat e tjera te kesaj pasqyre jane shuma e analizave respektive sipas posteve.

- **Te ardhurat neto te konstatuara** (rrjeshti 58) perbejne diferencen midis te TE ARDHURAVE GJITHSEJ (rrjeshti 1) dhe SHPENZIMEVE GJITHSEJ (rrjeshti 33). Ne te ardhuren neto te konstatuar perfshihen edhe rezultatet e mbartura e ato te ushtrimit. Pjesa me e madhe perfaqesohet nga grantet e konstatuara per funksionimin, te cilat kane perballuar shpenzimet e konstatuara. Ne kete diference jane edhe burimet e investimeve te cilat nuk jane objekt i kesaj pasqyre. Ne rrjeshtin 60 te kesaj pasqyre rezultatet e mbartura e te ushtrimit konsolidohen ne vleren neto te tyre dhe duhet te jene te barabarta me shumen e evidentuar ne rrjeshtin 98 te formatit 10“pasqyre e konsoliduar e gjendjes financiare“.
6. Pika (1) e rubrikes (I) dhe pikat 5, 6, 7 e 10 te rubrikes (III) te Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 14 date 28/12/2006 “Per pergatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore te vitit 2006 per Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njesive qe varen prej tyre si dhe te njesive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marreveshjeve me Donatore te Huaj”, shfuqizohen.
  7. Formati bashkelidhur i Pasqyrave Financiare Vjetore 2007 miratohet me kete udhezim.
  8. Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere

**Ridvan BODE**

---

**MINISTER**

Konceptoi; Enver KALEMASI, Pergjegjes Sektori

Konfirmoi; Ylber BEZO, Drejtor

Konfirmoi; Nezir HALDEDA, Drejtor I Pergjithshem